



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviç
10 000 Prishtina

RREGULLORE E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 23.03.2026



Në bazë të nenit 20, alineja 1.2 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme 'Kuvendi'), në mbledhjen e mbajtur më 23.03.2026 në Prishtinë, miratoi këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Kuvendit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, në pajtim me Statutin e Federatës së Basketbollit të Kosovës. Kjo Rregullore përcakton specifikisht dispozitat lidhur me:

1. Përgatitjen dhe konvokimin e mbledhjeve (seancave) të Kuvendit;
2. Udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit;
3. Mënyrën e aprovimit të vendimeve dhe konkluzioneve të Kuvendit; dhe
4. Informimin për punën e Kuvendit të Federatës.

Neni 2

1. Kuvendi punimet e veta i kryen në mbledhje plenare dhe publike. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta (Kuvend i Rregullt) dhe të jashtëzakonshme (Kuvend i Jashtëzakonshëm).
2. Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës do të mbajë së paku një mbledhje të rregullt në vit. Sipas nevojës, Kuvendi mund të konvokohet edhe më shpesh.
3. Në mbledhje të jashtëzakonshme Kuvendi mund të trajtojë vetëm çështjet për të cilat është konvokuar.



II. KONVOKIMI DHE MBAJTJA E MBLEDHJES

Neni 3

- 1.** Kuvendin e rregullt e konvokon Bordi i Federatës, me vendim.
- 2.** Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërret Kryetari, Bordi, dy të tretat (2/3) e Anëtarëve të Federatës, ose Këshilli Mbikëqyrës i Federatës.
- 3.** Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta thërrasë Kryetari i Federatës jo më vonë se 30 ditë pas konvokimit të tij nga organet e Federatës sipas paragrafit 2 të këtij neni. Në rast të moskonvokimit të Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Kryetari i Federatës, atë mund ta konvokojë edhe organi i Federatës që e ka iniciuar konvokimin e tij. Moskonvokimi i Kuvendit të Jashtëzakonshëm nga Kryetari i Federatës sipas dispozitave të këtij neni konsiderohet shkelje e rëndë e Statutit të Federatës dhe e kësaj Rregulloreje.
- 4.** Ftesa për Kuvend të Rregullt duhet tu dërgohet të gjithë Anëtarëve më së largu 14 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali që do shtjellohet në mbledhje së paku 7 ditë para mbledhjes. Ftesa për Kuvend të Jashtëzakonshëm duhet tu dërgohet të gjithë Anëtarëve më së largu 5 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali që do shtjellohet në mbledhje së paku 48 orë para mbledhjes.
- 5.** Ftesa nënshkruhet nga Kryetari i Federatës dhe përcillet me rendin e propozuar të ditës dhe të gjitha materialet që do shtjellohen në mbledhje të Kuvendit.
- 6.** Federata e Basketbollit të Kosovës mund të organizojë mbledhjet e Kuvendit në formë hibride ose online, kur rrethanat e jashtëzakonshme apo nevojat e veçanta të organizimit e kërkojnë një gjë të tillë. Pjesëmarrësit në këto mbledhje do të konsiderohen të pranishëm dhe me të drejtë vote në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, me kusht që të përdoren mjete teknologjike që sigurojnë identifikimin dhe pjesëmarrjen e plotë të anëtarëve dhe votim të sigurt dhe transparencë. Çdo vendim i kësaj natyre duhet të miratohet nga Bordi i FBK-së dhe të raportohet në Kuvendin e ardhshëm të rregullt për miratim.



7. Me synim ruajtjen e plotë të integritetit procedural mbi çështjet me ndjeshmëri më të lartë, pikat në vijim nuk mund të vendosen në mbledhjet e Kuvendit të mbajtura në formë online:

- 7.1.** Ndryshimet e këtij Statuti;
- 7.2.** Zgjedhjet për Kryetar dhe Anëtarë të Bordit të FBK-së;
- 7.3.** Pranimi ose përjashtimi i Anëtarëve të Federatës.

Neni 4

Materialet për mbledhjen e Kuvendit i përgatitë Sekretari i Përgjithshëm i Federatës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Federatës. Materialet për mbledhje të Kuvendit të Federatës i shqyrton dhe i miraton paraprakisht Bordi i Federatës.

III. UDHËHEQJA E MBLEDHJES SË KUVENDIT

Neni 5

- 1.** Mbledhjen e Kuvendit e hap Kryetari i Kuvendit i cili edhe propozon organet e punës së Kuvendit (Kryesinë e Punës së Kuvendit, Komisionin Verifikues dhe Procesmbajtësin). Zgjedhja e organeve të punës së Kuvendit duhet t'i paraprijë punimeve të Kuvendit. Komisioni Verifikues duhet të vërtetojë se në mbledhje marrin pjesë një numër i mjaftueshëm i delegatëve për të plotësuar kuorumin e domosdoshëm për marrjen e vendimeve në Kuvend, në pajtim me Statutin e Federatës. Mbledhja e Kuvendit mbahet nëse në të janë të pranishëm më tepër se gjysma e delegatëve të ftuar.
- 2.** Me punën e Kuvendit udhëheq kryesia e punës së Kuvendit në përbërje prej 3 (tre) anëtarësh. Kryesia e punës përbëhet nga Kryetari i Kuvendit dhe dy delegatë të Kuvendit, të cilët zgjedhen nga vetë Kuvendi me shumicë votash.
- 3.** Pas konstatimit se ekziston kuorumi, kryesuesi i seancës propozon miratimin e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit. Miratimi i rendit të ditës



bëhet me shumicë votash, ndërsa çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të propozojë ndërrimin ose plotësimin e rendit të ditës. Propozimet e tilla duhet të votohen nga të pranishmit.

4. Në rast se Kryetari i Kuvendit për çfarëdo arsye nuk është i pranishëm në mbledhje të Kuvendit, Kuvendin e udhëheq Nënkryetari më i vjetër i Bordit të Federatës, ose në mungesë të tij/saj, delegati më i vjetër i pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.

Neni 6

1. Diskutuesi mund të flasë vetëm për çështjen e cila është duke u shqyrtuar sipas rendit të ditës. Nëse diskutimi devijon nga rendi i ditës, Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia tërheq vërejtjen ose ta ndërpresë diskutimin.

2. Asnjë diskutues nuk mund ta marrë fjalën më tepër se një herë për një pikë të caktuar të rendit të ditës. Diskutimi i delegatëve mund të zgjas më së shumti pesë (5) minuta.

3. Secili delegat ka të drejtë në një replikë (e cila zgjatë jo më shumë se një minutë) nëse i përmendet, apo i apostrofohet emri në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

IV. MËNYRA E MIRATIMIT TË VENDIMEVE TË KUVENDIT

Neni 7

1. Kuvendi miraton vendimet dhe konkluzionet e veta me shumicë votash. Propozimi për të cilin votohet, konsiderohet si i aprovuar vetëm nëse për të deklarohen më tepër se 50% të delegatëve të pranishëm në Kuvend.

2. Përjashtimisht dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni, votimi për ndryshimin e Statutit të Federatës dhe votimi për çështje tjera për të cilat është e paraparë një shumicë e kualifikuar e delegatëve duhet të miratohen nga dy të tretat (2/3) e delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.

3. Votimi në Kuvend është publik, përveç në rastet kur Kuvendi i zgjedh organet e veta, kur votimi mund të bëhet në mënyrë të fshehtë, të hapur apo me aklamacion.



4. Votimin me vota të fshehura e udhëheq komisioni zgjedhor prej tre (3) anëtarësh të cilët propozohen dhe zgjedhen nga delegatët e pranishëm. Mandati i tyre zgjatë vetëm për një seancë. Me rezultatet e votimit, Kuvendin e informon kryetari i Komisionit zgjedhor.

V. ZGJEDHJA DHE EMËRIMI I ORGANEVE TË FEDERATËS

Neni 8

- 1.** Kuvendi është kompetent për zgjedhjen e Kryetarit, dy nënkryetarëve dhe nëntë anëtarëve të Bordit dhe Këshillit Mbikëqyrës të Federatës.
- 2.** Të drejtën e propozimit të kandidatëve për Kryetar të Federatës e kanë a) Bordi i Federatës i cili mund të propozojë një kandidat, dhe b) shtatë anëtarë të Kuvendit, në pajtim me Statutin e Federatës, të cilët kanë të drejtë të propozojnë një kandidat.
- 3.** Në rast të zgjedhjes me votim, Kryetar i Federatës konsiderohet kandidati që ka fituar së paku një votë më shumë se gjysma e votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin në rrethin e dytë të votimit delegatët e Kuvendit votojnë për dy (2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave. Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar zgjedhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.
- 4.** Të drejtën e propozimit të kandidatëve për nënkryetarë e kanë a) Kryetari, i cili mund t'i propozojë dy kandidatë, dhe b) Kuvendi që mund t'i propozojë dy kandidatë tjerë. Nënkryetarë do të zgjedhen dy kandidatët që marrin numrin më të madh të votave të delegatëve.
- 5.** Tre (3) anëtarë të Bordit, nga të cilët së paku një i gjinisë femërore, emërohen dhe shkarkohen me vendim të Kryetarit të Federatës pas marrjes së postit të Kryetarit. Ndërsa kandidatët tjerë (së paku një nga radha e gjinisë femërore) për anëtarë të Bordit i propozojnë delegatët e Kuvendit. Anëtarë të Bordit zgjedhen shtatë kandidatët që fitojnë më së shumti vota. Në rast se në mesin e shtatë kandidatëve me më shumë vota nuk është asnjë



femër, atëherë vendin e anëtarit të shtatë e zë kandidatja femër që ka më shumë vota.

6. Tre anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Federatës i propozojnë delegatët e Kuvendit, ndërsa në rast se paraqiten më shumë se tre anëtarë, anëtarësinë në këtë Këshill e fitojnë kandidatët që marrin më së shumti vota.

VI. MËNYRA E INFORMIMIT ME PUNËN E KUVENDIT

Neni 9

- 1.** Me punën e Kuvendit rregullisht informohen anëtarët e Federatës dhe opinioni publik. Informimi bëhet me anë të mjeteve të informimit, raporteve, buletineve, informatorëve dhe procesverbaleve.
- 2.** Të gjitha vendimet e Kuvendit publikohen edhe në ueb faqen zyrtare të FBK-së në mënyrë të qartë dhe të qasshme për publikun.
- 3.** Për punën e Kuvendit dhe organeve të tij në mbledhje në mënyrë të obligueshme mbahet procesverbali nga procesmbajtësi. Në procesverbal duhet të shënohet e tërë rrjedha e mbledhjes së Kuvendit. Procesverbalin e nënshkruajnë Kryetari dhe procesmbajtësi.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 10

- 1.** Kjo Rregullore konsiderohet e aprovuar po qe se për të voton shumica e anëtarëve të Kuvendit. Çdo ndryshim apo plotësim i Statutit zbatohet automatikisht edhe në këtë Rregullore. Në rast mospërputhjeje ndërmjet Statutit dhe kësaj Rregulloreje, përparësi ka Statuti, ndërsa kjo Rregullore do të harmonizohet dhe ndryshohet përkatësisht me ndryshimet e bëra në Statut.
- 2.** Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje, bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse edhe miratimi i saj.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

KUVENDI I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Kryetari
Arben **FETAHU**

Prishtinë, 23.03.2026

